

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Detaje nga vdekja e Giorgos Mazonakis/ Zbulohen dy foto dhe një video e fshirë nga telefoni i mjekes
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/14/detaje-nga-vdekja-e-giorgos-mazonakis-zbulohen-dy-foto-dh-e-nje-video-e-fshire-nga-telefoni-i-mjekes/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 17:08:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 17:04:23 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4c4d00b7c1e65b6959c25c83be6bf568e27ded4197169b03a2391b0eb0365943
TEKSTI	0c6cb30ba189529876039218ab5808579f3fb81fd2ecad641bd2053c4cceb3fd
PAMJA	2e8b451d94d90f5a4312064b67f729f98749dbf1cf4b64aee81d932a58fed1e0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d8107f21684ae7b28010ab709554d18b1227ade428ded1966299c9b410c4b1ce
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7b2b016d700840f0d00306452beff4854c87a5a9cfd79fec123f45a77e434d02
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d8107f21684ae7b28010ab709554d18b1227ade428ded1966299c9b410c4b1ce>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > RAJONI

Detaje nga vdekja e Giorgos Mazonakis/ Zbulohen dy foto dhe një video e fshirë nga telefoni i mjekes

19:04 : 14/09/2026 në RAJONI, SHOW BIZ



Të dhëna të reja digjitale dhe veçanërisht të rëndësishme për orët e fundit para vdekjes së Giorgos Mazonakis kanë dalë nga ekspertiza laboratorike e kryer nga Drejtoria e Hetimeve Kriminalistike në telefonin e mjekes Ioanna Gaka.

Ekspertët kanë arritur të rikuperojnë nga pajisja dy fotografi të fshira dhe një video, të krijuara gjatë pasdites së 9 shtatorit, brenda një intervali prej vetëm pak minutash. Sipas të dhënave të tjera të hetimit, në atë kohë këngëtari ndodhej në klinikën në rrugën Karneadou.

Njëra prej fotografive rezultojnë gjithashtu se është shpërndarë, pra është dërguar nga telefoni i Gakës në një numër tjetër.

Elementi edhe më i rëndësishëm është se të tria skedarët janë fshirë pothuajse në të njëjtën kohë, pak pas orës 19:09 të së njëjtës ditë.

Bëhet fjalë për orët kur dy mjekët, Ioanna Gaka dhe Ilias Theodoropoulos, po kërkoheshin nga autoritetet greke dhe më pas, në orën 19:45, shkuan për të dhënë dëshmi në komisariatin e Kypselit në lidhje me ngjarjen.

Lexo edhe:

[Përmblytet varka me emigrantë në jug të Greqisë, 1 i vdekur dhe 20 të zhdukur](#)

[Alket Rizai duhej të kthehej sot në burg, por u zhduk pas të shtënave me armë/ Si ndodhi shërri në plazhin grek](#)

Ekspertiza përcakton me saktësi oraret e krijimit, marrjes dhe fshirjes së skedarëve.

Fotografia e parë është marrë në orën 14:43:36 të 9 shtatorit. Skedari rezultojnë të jetë krijuar në orën 14:44:19 dhe më pas është fshirë në 19:09:09.

Me rëndësi të veçantë është fakti se fotografia përmban edhe të dhëna për vendndodhjen gjeografike. Koordinatat e gjetura në të dhënat e fotografisë përkrijnë, sipas hetimit të Drejtorisë së Hetimeve Kriminalistike, me një pikë në rrugën Karneadou në Athinë, ku ndodhet klinika.

TË GJITHA



Detaje nga vdekja e Giorgos Mazonakis/ Zbulohen dy foto dhe një video e fshirë nga telefoni i mjekes

19:04 : 14/09/2026



"Territorialja"/ Divjaka kundër bashkimit me Lushnjën. Gati relacioni për në Kuvend

18:57 : 14/09/2026



"AMG Food" e skandalit të Salmonelës, pronare e kontejnerit me mish pule ku u gjetën 41 kg kokainë

18:47 : 14/09/2026



"Pseudodëgjesat e Ramës"/ Kalaja: Në Poliçan u dogjën taserat e PS, nuk kishte ndodhur as me Enverin

18:25 : 14/09/2026



Do të... Universiteti Ndërkombëtar i Mjekësisë në Fier

18:13 : 14/09/2026



"Po ekspozon jetën e njerëzve"/ OKB kërkon ndërhyrje urgjente për Inteligjencën Artificiale

18:01 : 14/09/2026



VIDEO/ Gjymnazistët të "Qemal Stafa" bojkotuan mësimin, thirrje Ramës për dorëheqje

17:46 : 14/09/2026

Pikërisht për këtë fotografi ekspertët kanë gjetur edhe gjurmë digjitale të shpërndarjes së saj.

Fotografia e dytë është marrë në orën 14:45:22 dhe është krijuar si skedar katër sekonda më vonë, në 14:45:26. Edhe kjo fotografi është gjetur e fshirë.

Sipas të dhënave të disponueshme, ky ishte momenti kur Mazonakis kishte nisur procedurën e plazmaferезës.

Fotografia e dytë është fshirë në orën 19:09:13, vetëm katër sekonda pas fshirjes së fotografisë së parë. Edhe ajo përmbante të njëjtat koordinata gjeografike, që çojnë në rrugën Karneadou.



Sipas informacioneve, në njërën prej dy fotografive Giorgos Mazonakis shfaqet i shtrirë në shtratin e klinikës, ndërsa aparatura është në funksion. Ai mban veshur një bluzë të verdhë me mëngë të shkurtra dhe është i mbuluar me batanije nga mesi e poshtë. Koka i është kthyer në të djathtë dhe sytë i ka të mbyllur.

Në dorën e djathtë i dallohet një kateter intravenoz, ndërsa një lidhje e ngjashme duket edhe në dorën e majtë.

Në të njëjtën pajisje është gjetur edhe një video e fshirë. Nga të dhënat e saj rezulton se videoja është krijuar në orën 14:43:55, pra në intervalin kohor mes dy fotografive.

Edhe videoja ishte fshirë dhe, sipas ekspertizës, fshirja është kryer në orën 19:09:13.

Kronologjia e skedarëve digjitalë është si më poshtë:

14:43:36 – merret fotografia e parë

14:43:55 – krijohet videoja

14:45:22 – merret fotografia e dytë

19:09:09 – fshihet fotografia e parë

19:09:13 – fshihen fotografia e dytë dhe videoja

Për të përcaktuar se ku është dërguar fotografia e parë do të nevojitet heqja e sekretit telefonik.

Të tre skedarët janë gjetur në hapësirën e ruajtjes DCIM të telefonit të Ioanna Gakës, pra në dosjen standarde ku zakonisht ruhen materialet fotografike dhe video në pajisjet Apple.

Ekspertët theksojnë megjithatë se në këtë dosje mund të gjenden edhe skedarë të importuar përmes AirDrop ose të sinkronizuar përmes iCloud Photos. Për dy fotografitë, megjithatë, ekzistojnë të dhëna specifike për marrjen e tyre dhe vendndodhjen në rrugën Karneadou.

Sipas të dhënave të publikuara më herët, procedura e plazmaferезës kishte nisur në orën 14:37. Në bazë të këtij informacioni, fotografitë duket se janë marrë pak pasi këngëtari kishte mbërritur në klinikë dhe kishte nisur procedurën.

Në orën 15:22 regjistrohet alarmi i parë dhe, sipas të dhënave që po shqyrtohen, në atë moment duket se procedura është ndërprerë. Më pas janë regjistruar edhe sinjale të tjera alarmi nga aparatura, një në 15:23 dhe dy të tjera në 15:45.

Megjithatë, telefonata drejt shërbimit të urgjencës mjekësore EKAB është regjistruar vetëm në orën 16:11.

Në bazë të këtyre të dhënave, pyetja kryesore e hetimit tashmë lidhet me atë që ndodhi brenda klinikës nga ora 15:22, kur u shfaq sinjali i parë i alarmit, deri në 16:11, kur u kërkuua përfundimisht ndihma e urgjencës.

Nga të dhënat e deritanishme, kronologjia paraqitet kështu:

14:37 – nis procedura e plazmaferezës.

15:22 – aparatura regjistron alarmin e parë. Në këtë moment duket se procedura ndërpritet.

15:23 – regjistrohet një tjetër alarm.

15:45 – regjistrohet një tjetër sinjal alarmi.

16:11 – kryhet telefonata drejt EKAB.

Kjo do të thotë se nga alarmi i parë deri në telefonatën për ndihmë mjekësore kanë kaluar 49 minuta.

Ky interval konsiderohet tashmë një nga momentet më kritike të hetimit, pasi autoritetet po përpiqen të përcaktojnë se çfarë nënkuptonin alarmet e aparaturës, në çfarë gjendjeje ishte këngëtari në atë moment, çfarë veprimesh u ndërmorën nga personat e pranishëm dhe pse ndihma nuk u kërkuua më herët.

Sipas informacioneve që po vlerësohen, thirrja për ndihmë urgjente mjekësore duhej të ishte bërë që në momentin e shfaqjes së alarmit të parë, në orën 15:22. Pikërisht kjo çështje pritet të jetë një nga elementet kryesore të hetimit.

Një tjetër element i rëndësishëm për rindërtimin e ditës është dëshmia e shoferit të taksisë që transportoi Giorgos Mazonakis nga shtëpia e tij në Voula drejt rrugës Karneadou.

Shoferi ka dëshmuar se këngëtari kishte komunikuar me të që në orët e para të mëngjesit të 9 shtatorit dhe kishte kërkuar që ta merrte në orën 12:00, pasi dëshironte të ishte në Kolonaki në orën 13:00.

Shoferi mbërriti para shtëpisë së Mazonakis në orën 11:55. Këngëtari u vonua duke u përgatitur dhe doli rreth orës 13:15-13:20.

Shoferi vuri re se Mazonakis kishte një gërvishtje në ballë dhe mbante një pecetë mbi plagë. Ai i sugjeroi të ndalonin në farmaci, gjë që këngëtari e pranoi. Ata ndaluan në një farmaci në bulevardin Vouliagmenis, në Glyfada, ku gërvishtja u mbulua me leukoplast. Më pas vijuan rrugën drejt Kolonakit pa ndalesa të tjera.

Mazonakis i kërkoi shoferit ta dërgonte konkretisht në adresën Karneadou 11, pa i shpjeguar se çfarë do të bënte atje. Sipas dëshmisë, taksia mbërriti në Karneadou rreth orës 13:50-13:59.

Këngëtari zbriti nga dera e pasme e djathtë dhe u drejtua drejt pallatit, ndërsa shoferi u largua për të pritur në një zonë aty pranë. Mazonakis i kishte thënë se do të qëndronte rreth dy orë.

Dy burrat kishin rënë dakord që taksia ta priste dhe, pasi të përfundonte takimi në Kolonaki, ta transportonte më pas drejt Kifisias, ku këngëtari llogariste të qëndronte rreth dy orë.

Pasi kaluan rreth dy orë e gjysmë pa marrë asnjë telefonatë nga këngëtari, taksisti kontaktoi kolegun e tij për ta zëvendësuar në turn. Ndërrimi u bë rreth orës 17:15 dhe deri në atë moment Giorgos Mazonakis nuk kishte telefonuar asnjërin prej tyre për t'i njoftuar se kishte përfunduar.

Rreth orës 17:30, ndërsa shoferi po shkonte drejt shtëpisë, një mik e telefonoi dhe e informoi se këngëtari kishte ndërruar jetë.

Me interes është edhe përshkrimi që shoferi i bëri gjendjes së Mazonakis gjatë udhëtimit. Ai ka dëshmuar se e njihte prej rreth 24 vitesh dhe e kishte transportuar disa herë, edhe pse jo rregullisht.

Sipas tij, atë ditë nuk kishte vënë re ndonjë sjellje të pazakontë apo shqetësuese. Mazonakis,

sipas dëshmitarit, dukej njësoj si në rastet e tjera kur e kishte transportuar.

Shoferi ka deklaruar gjithashtu se kur më vonë mësoi nga lajmet se këngëtari kishte shkuar në Kolonaki për t'iu nënshtruar një trajtimi të rëndësishëm, mbeti i tronditur, pasi sipas përshtypjes së tij atë ditë, *“nuk kishte pamjen e një njeriu të sëmurë”*.

Etiketa: Giorgos Mazonakis Greqi hetime vdekje

Lajme të lidhura



Përmbytet varka me emigrantë në jug të Greqisë, 1 i vdekur dhe 20 të zhdukur

15:29 : 14/09/2026



Alket Rizai duhej të kthehej sot në burg, por u zhduk pas të shtënave me armë/ Si ndodhi sherri në plazhin grek

09:04 : 14/09/2026




Aksident në aksin Qishbardhë-Peshkëpi, përplasen dy makina, disa të plagosur

14:59 : 13/09/2026



Sherr me thika në Athinë, përleshjen 15 persona, mes tyre edhe shqiptarë

14:25 : 13/09/2026



DETAJE nga tritoli në Shkodër/ Autori u maskua si korrier picash, objektivi vëllai i mësuesit ?

13:36 : 13/09/2026



“Më jep 300 mijë € ose...”/ 56-vjeçari vlonjat kërcënon kushëririn, i vendos fishek te porta

12:40 : 13/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.
Na kontakto:

NA NDIQ

